



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr 12-400/21-17674 dt. 28.04.2021

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34,pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores Nr. 12-400-16581, të datës 27.05.2020, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha, nenit 2, 10, 11 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, me ndryshimet e tij sipas ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shpalljes së virusit COVID-19, si pandemi, Rekomandimit Nr. 01-020/04-16642, të datës 23.04.2021, të komisionit për dhënie të rekomandimit lidhur me mundësinë e heqjes së taksës së operimit dhe shfrytëzimit të hapësirave publike (Gastronomisë) për vitin 2021, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë **28.04.2021**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për lirim nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet lrimi nga taksa e operimit për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.

Neni 2

Bizneset e liruar nga taksa e operimit për vitin fiskal 2021, janë të përcaktuara/përfshira në nenin 13 të Rregullores Nr. 12-400-16581, të datës 27.05.2020, ndërsa për lirim nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike të bizneseve të gastronomisë sipas listës së Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj